



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.legjislacioni.gov.al

Nr. 124

Datë 8 gusht 2014

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 70/2014 datë 10.7.2014	Për shërbimin për çështjet e brendshme dhe ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme	5709
Ligj nr. 71/2014 datë 10.7.2014	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar	5724
Ligj nr. 72/2014 datë 10.7.2014	Për përdorimin e armëve të zjarrit.....	5728
Ligj nr. 73/2014 datë 10.7.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9126, datë 29.7.2003, “Për përdorimin civil të lëndëve plasëse dhe lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar	5730
Ligj nr. 75/2014 datë 10.7.2014	Për shërbimin privat të sigurisë fizike.....	5731
Ligj nr. 76/2014 datë 10.7.2014	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, të ndryshuar	5740
Ligj nr. 77/2014 datë 10.7.2014	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 039, datë 22.12.2008, “Për ndihmën juridike”, të ndryshuar.....	5742
Ligj nr. 78/2014 datë 10.7.2014	Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare	5744

2, dhe 33, pika 5, drejtuesit teknik i jepet gjobë në masën nga 10 000 (dhjetë mijë) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

2. Të ardhurat nga këto gjoba derdhen në Buxhetin e Shtetit.

Neni 46

Gjopa për punonjës in e shërbimit

1. Për shkeljet e konstatuara për moszbatim të kërkesave të neneve 23, pikat 1 dhe 2, 27, 30, 33, pika 5, e 34, pika 1, të këtij ligji, punonjës it të shërbimit i jepet gjobë nga 3 000 (tre mijë) deri në 20 000 (njëzet mijë) lekë.

2. Të ardhurat nga këto gjoba derdhen në Buxhetin e Shtetit.

Neni 47

Kompetenca e dhënies së masave

1. Dhënia e masave administrative, sipas neneve 44, 45 dhe 46, të këtij ligji, është kompetencë e drejtorit të policisë së qarkut.

2. Dhënia e masave administrative, sipas neneve 40 dhe 41, të këtij ligji, është kompetencë e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë.

Neni 48

Tarifat financiare

1. Aplikimi për lëshimin e licencave/certifikatave, sipas dispozitave të veçanta të këtij ligji, kryhet kundrejt pagesës së tarifave për shërbimin administrativ.

2. Në rast lëshimi të licencës apo certifikatës, subjekti përkatës paguan tarifën e licencimit/certifikatës në afatin e caktuar nga organi përgjegjës për lëshimin e titullit.

3. Mospagimi i tarifës sjell revokimin e titullit, sipas dispozitave të këtij ligji.

4. Masa, kriteret dhe procedura për tarifat financiare përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe institucioneve përkatëse.

KREU VI

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 49

Dispozita kalimtare

Licencat aktive, të dhëna në zbatim të ligjit nr. 8770, datë 19.4.2001, "Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike", të ndryshuar, e ruajnë vlefshmërinë e tyre deri në një 1 vit nga hyrja në fuqi e këtij ligji, me të drejtën e aplikimit të ri për pajisje me licencë, sipas kushteve dhe kriterëve të këtij ligji.

Neni 50

Aktet nënligjore

1. Ministri i Financave, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nxjerr udhëzim të përbashkët me institucionet përkatëse, në zbatim të nenit 48, pika 4.

2. Ministri, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nxjerr aktet nënligjore në zbatim të neneve 5, pika 6; 20, pika 2; 21, pika 4; 23, pika 4; 29, pika 4; 37, pika 2, dhe 38, pika 4, të këtij ligji.

3. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nxjerr urdhrat në zbatim të neneve 28, pika 2, dhe 36, pika 2, të këtij ligji.

Neni 51

Dispozita përfundimtare

Ligji nr. 8770, datë 19.4.2001, "Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike", i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 52

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 10.7.2014

Shpallur me dekretin nr. 8651, datë 30.7.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ

Nr. 76/2014

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9636, DATË 6.11.2006, "PËR MBROJTJEN E SHËNDETIT NGA PRODUKTET E DUHANIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006, "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit", të ndryshuar, bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

Pas nenit 14 shtohet neni 14/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 14/1

1. Radiotelevizioni Publik Shqiptar transmeton çdo muaj programe edukative për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit, në përputhje me ligjin për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë. Këto programe edukative kanë një kohëzgjatje në total prej 90 minutash dhe transmetohen nga ora 8⁰⁰ deri në orën 22⁰⁰. Një prej këtyre programeve, me kohëzgjatje prej 30 minutash transmetohet detyrimisht nga ora 17⁰⁰ deri në orën 22⁰⁰.

2. Në faqet zyrtare të internetit të institucioneve publike publikohen, në vend të dukshëm, mesazhe informuese për

ndikimet e duhanpirjes në shëndet dhe rreziqet nga produktet e duhanit.”

Neni 2

Neni 15 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 15

1. Ndalohet pirja e duhanit në:

- a) mjediset e punës;
- b) institucionet shëndetësore, me përjashtim të institucioneve të shëndetit mendor (vetëm për pacientët);
- c) institucionet arsimore, përfshirë dhe çerdhët;
- ç) mjetet e transportit publik, përfshirë taksitë;
- d) mjediset e mbyllura tregtare, bare, restorante, diskoteka dhe klubet e natës;
- dh) mjediset e mbyllura kulturore e sportive;
- e) mjediset e përbashkëta, në banesat me bashkëpronësi të detyrueshme;
- ë) mjediset e tjera publike të mbyllura.

2. Në mjediset/institucionet e mësipërme nxirret një rregullore e brendshme, ku theksohet ndalimi i pirjes së duhanit në këto mjedise dhe përcaktohet qartë personi, i cili do të jetë përgjegjës për rastet e shkeljes.”

Neni 3

Neni 16 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 16

Pronari ose administratori i mjediseve të përcaktuara në nenin 15 të këtij ligji apo personi i caktuar prej tyre është përgjegjës për vendosjen në një vend të dukshëm të listës së trupave inspektuese për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit, të shenjave të dukshme, që tregojnë se pirja e duhanit në këto mjedise është e ndaluar, si dhe të heqë e të mos lejojë vendosjen e tavllave të duhanit në këto mjedise. Forma dhe teksti i shenjave paralajmëruese përcaktohen nga KNMSHPD-ja.”

Neni 4

Neni 19 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 19

1. Institucionet përgjegjëse për kontrollin e zbatimit të këtij ligji janë:

- a) inspektorati që mbulon fushën e shëndetit, organet e administratës doganore dhe organet tatimore, për shkeljen e neneve 4, 5 dhe 6. Në rastet kur këto institucione zhvillojnë kontrolle të përbashkëta, ato duhet të bashkërendojnë punën për këtë qëllim;
- b) organet tatimore, për shkeljen e nenit 9;
- c) inspektorati që mbulon fushën e shëndetit, për shkeljen e shkronjës “a”, të nenit 10;

ç) inspektorati që mbulon fushën e arsimit, për shkeljen e shkronjave “b” dhe “c”, të nenit 10;

d) organet tatimore, për shkeljen e shkronjave “ç”, “d” e “dh”, të nenit 10;

dh) inspektorati që mbulon fushën e shëndetit dhe organet tatimore, për shkeljen e neneve 11, 12, 13 dhe 14;

e) inspektorati që mbulon fushën e punës, fushën e shëndetit dhe inspektorati i sigurisë ndaj zjarrit, për shkeljen e shkronjës “a”, të nenit 15;

ë) inspektorati që mbulon fushën e shëndetit, për shkeljen e shkronjës “b”, të nenit 15;

f) inspektorati që mbulon fushën e arsimit dhe ai që mbulon fushën e shëndetit, për shkeljen e shkronjës “c”, të nenit 15;

g) Policia e Shtetit dhe policia bashkiake/komunare, për shkeljen e shkronjës “ç”, të nenit 15;

gj) inspektorati që mbulon fushën e punës, inspektorati që mbulon fushën e shëndetit dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për shkeljen e shkronjës “d”, të nenit 15;

h) inspektorati që mbulon fushën e shëndetit dhe inspektori i policisë së zonës, për shkeljen e shkronjës “dh”, të nenit 15;

i) policia bashkiake/komunare dhe inspektori i policisë së zonës, për shkeljen e shkronjës “e”, të nenit 15;

j) inspektorati që mbulon fushën e shëndetit, për shkeljen e shkronjës “ë”, të nenit 15.

2. Trupat inspektuese, sipas përcaktimit të pikës 1, të këtij neni, bëjnë verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, që burojnë nga ky ligj, në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

3. Inspektorati Qendror bashkërendon veprimtarinë inspektuese të trupave, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni. Ngarkohet inspektorati që mbulon fushën e shëndetit për monitorimin e zbatimit të këtij ligji dhe mbledhjen e informacionit nga trupat e tjerë inspektues në zbatim të tij.”

Neni 5

Neni 20 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 20

1. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) shkelja e neneve 4 e 5, pika 1, shkronjat “ç”, “d” e “dh” dhe pika 3, si dhe nenit 6 dënohet me konfiskim, asgjësim të mallit dhe 5 000 000 (pesë milionë) lekë gjobë, sipas rastit, për importuesin e produktit apo prodhuesin vendas;

b) shkelja e nenit 9 dënohet me konfiskim të produkteve të duhanit dhe 100 000 (njëqind mijë) lekë gjobë për subjektin shitës me shumicë apo pakicë të produkteve të duhanit;

c) shkelja e nenit 10 dënohet me konfiskim të produkteve të duhanit dhe 100 000 (njëqind mijë) lekë gjobë, sipas rastit, për subjektin shitës me pakicë ose subjektin e tatueshëm të veprimtarisë së parashikuar;

ç) shkelja e nenit 11 dënohet me konfiskim të produkteve të duhanit dhe 20 000 (njëzet mijë) lekë gjobë për shitësin me pakicë;

d) shkelja e nenit 12 dënohet me konfiskim të produkteve të duhanit dhe 100 000 (njëqind mijë) lekë gjobë, sipas rastit, për subjektin prodhues, importues apo tregtues, që ka kryer shkeljen;

dh) shkelja e nenit 13, paragrafi i parë dhe i dytë, dënohet me 3 000 000 (tre milionë) lekë gjobë, për subjektin e tatueshëm të veprimtarisë së reklamës, medias së shkruar, transmetimit televiziv, radiofonik apo të shërbimit të shoqërisë së informacionit;

e) shkelja e nenit 14 dënohet me 3 000 000 (tre milionë) lekë gjobë për subjektin prodhues, importues apo tregtues të produkteve të duhanit, që ka kryer shkeljen;

ë) shkelja e nenit 15 dënohet me gjobë si më poshtë:

i) 300 000 (treqind mijë) lekë, subjekti i tatueshëm;

ii) 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, personi përgjegjës në institucionet publike;

iii) 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, administratori në banesat me bashkëpronësi të detyrueshme;

iv) 5 000 lekë (pesë mijë) lekë, duhanpirësi;

f) shkelja e nenit 16 dënohet me gjobë si më poshtë:

i) 300 000 (treqind mijë) lekë, subjekti i tatueshëm;

ii) 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, administratori apo personi i caktuar përgjegjës.

2. Masa e konfiskimit dhe e asgjësimit janë dënime kryesore, ndërsa masa e gjobës është dënim kryesor, kur parashikohet si dënim më vete dhe dënim plotësues, kur jepet njëkohësisht me masën e konfiskimit ose asgjësimit.

3. Ankimi ndaj vendimeve të trupave inspektuese, të përcaktuara në këtë ligj, bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin, ndërsa ankimi ndaj organeve tatimore, doganore, Policisë së Shtetit, policisë bashkiake ose të komunës, sipas legjislacionit në fuqi. Pas përfundimit të procedurave të ankimit administrativ, bëhet ankim në gjykatën administrative, brenda afateve dhe sipas procedurave të parashikuara në dispozitat e ligjit nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

4. Të ardhurat nga gjobat e vendosura, sipas këtij neni, derdhen në Buxhetin e Shtetit".

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 10.7.2014

Shpallur me dekretin nr. 8652, datë 30.7.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

5742

LIGJ
Nr. 77/2014

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË
LIGJIN NR. 10 039, DATË 22.12.2008, "PËR
NDIHMËN JURIDIKE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 039, datë 22.12.2008, "Për ndihmën juridike", të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 2, fjalia e parë riformulohet si më poshtë:

"Ushtrimi efektiv i së drejtës për t'iu drejtuar organeve të administratës publike dhe/ose të sistemit të drejtësisë, nëpërmjet dhënies së ndihmës juridike nga shteti për individët, mbështetet në parimet:".

Neni 2

Në nenin 10, pas shkronjës "j" shtohet shkronja "k" me këtë përmbajtje:

"k) i propozon Dhomës Kombëtare të Avokatisë, në rast të shkeljes së dispozitave të këtij ligji, fillimin e procedimit disiplinor për marrjen e masave të pezullimit ose heqjes së lejes së ushtrimit të profesionit të avokatit, në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë.".

Neni 3

Në nenin 11, titulli ndryshohet si më poshtë:
"Ndihma juridike dhe llojet e saj".

Neni 4

Pas nenit 11 shtohet neni 11/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 11/1

Subjektet përfitues të ndihmës juridike

Subjektet përfitues të ndihmës juridike janë:

a) shtetasit shqiptarë me vendbanim në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) shtetasit e huaj që e përfitojnë atë mbi bazën e parimit të reciprocitetit;

c) personat pa shtetësi, të pajisur me leje qëndrimi, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) personat me shtetësi të huaj ose personat pa shtetësi, që kërkojnë të pajisjen me leje qëndrimi, aplikojnë për azil ose që janë në proces ankimi të vendimeve administrative